

KONTRATË PËR SHITJEN DHE TRASFERIMIN E KUOTËS

Sot më datë 15/01/2025, bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të Shoqërisë “BLACK RIVER PV” Sh.p.k, si më poshtë vijon:

PALËT

Pala Shitëse: **Z. Sokol Tasha**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 27.04.1998 dhe banues në Gjoricë, Bulqizë me kartë identiteti Nr. Personal J80427004M, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Pala Blerëse: Shoqëria **SYA Holdings shpk**, person juridik, i regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) **M42210023A**, me adresë në *Tiranë, Don Bosko, Rruga Esherf Frasheri, Blloku Nr. 3, Ap. nr 8, ZK 9/3*, përfaqësuar ligjërisht nga Administratorja **Zj. Sidorela Hysenaj**

KUSHTET PARAPRAKE

- Shoqëria “Black River PV” shpk, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) M51308005Q, me zyrë qendrore në Tiranë, Don Bosko, Rruga Esherf Frasheri, Blloku Nr. 3, Ap. nr. 1, ZK 9/3, me kapital të regjistruar 100,000 (njëqind mijë) lekë; me ortak të vetëm Z. Sokol Tasha, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- Pala shitëse është e interesuar të shesë pjesën e kuotës e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Black River PV” shpk dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë pjesë të kuotës;
- Palët paraprakisht kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse në llogarinë bankare të Shitësit.

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI



2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse **Z. Sokol Tasha**, i shet palës blerëse “SYA Holdings” Shpk pjesën takuese prej 100% (njëqind përqind) të vlerës së kapitalit të plotë të kuotave të regjistruara për shoqërinë “Black River PV” shpk,

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në QKB, struktura e ortakëve e shoqërisë “Black River PV” shpk, do të jetë:

- *Shoqëria “SYA Holdings” Shpk me nr. NUIS M42210023A do të zoterojë 100 % të pjesës takuese të shoqërisë;*

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së pjesës së kuotës objekt i kësaj kontrate, është **100.000 lek** (njëqind mijë lek), ose e konvertuar në EURO me kursin e ditës.

3.2 Çmimi i kontratës do të likujdohet nga pala blerëse brenda një jave nga nënshkrimi i kontratës në llogarinë e Shitësit sipas të dhënave bashkëngjitur kësaj Kontrate.

Pjesë bashkëngjitur e kësaj kontrate do të jetë mandati bankar, ku duhet të jetë pasqyruar shuma e sipërpërmendur.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.2 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe bashkëngjitur mandati bankar i pagesës të shumës përcaktuar në këtë kontratë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e pjesën e kuotës që përfaqëson në kapitalit të shoqërinë “Black River PV” shpk dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse.

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) njësi origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një original regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

PALA SHITËSE

Z. Sokol Tasha

SOKOL TASHA



PALA BLERËSE

SYA HOLDINGS SHPK

Administratore

Znj. Sidorela Hysenaj



Të dhënat e llogarisë bankare të Shitësit

CREDINS bank

TË DHËNAT E LLOGARISË
ACCOUNT DETAILS

Banka / The Bank

CREDINS BANK sh.a., RRUGA 'VASO PASHA', Nr. 8, TIRANË

Kodi SWIFT / SWIFT Code

CDISALTRXXX

Titullari i Llogarisë / Account Holder

TASHA SOKOL ALUSH

Nr.Personal | NIPT / SSN | Tax ID

J80427004M

Adresa e Klientit / Customer Address

RR. EGNANTIA, BANESE PRIVATE NR 44, TIRANE

Numri i Llogarisë / Account Number

00001592944

Monedha / Currency

ALL

Data e Çeljes / Account Start Date

06.10.2021

IBAN*

AL73 2121 1009 0000 0000 0159 2944

